

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Parlamenti Studentor: Më 21 shtator marsh paqësor në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së
ADRESA	https://www.koha.net/arberi/parlamenti-studentor-me-21-shtator-marsh-paqesor-ne-mbeshtetje-te-ish-krereve-te-uck-se
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	21 shtator 2026, 03:16:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 11:27:19 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c18ad0792640b43d4e25ff907c3486c21e53342af79ab42e2f2f7bf48afd557c
TEKSTI	5f1cec70c59760efe0fb39b7d277a043bc97a0f19c4cdca5ac4ef965e7daec4d
PAMJA	339eb832231f1e9651c391656c05785da2fd95c0054234e9c1b362d6872d077e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e48e704b0fe9c3f6664531c9ab194c5836eae46f0afa3a93db735738ccc5ded0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e584beb7c9a24fc4e9785daf74a70f827c32290b3a409bd6ab23cf95a1fa39ba
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e48e704b0fe9c3f6664531c9ab194c5836eae46f0afa3a93db735738ccc5ded0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën

Kontribuo →

Letër lexuesit

ARBËRI

Parlamenti Studentor paralajmëron marsh paqësor për të hënë kundër vendimit të Speciales



20 shtator 2026 13:27

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalim tonë zyrtar në Viber

Parlamenti Studentor i Universitetit të Prishtinës ka bërë thirrje për pjesëmarrje në marshin paqësor që do të mbahet më 21 shtator, në shenjë kundërshtimi ndaj vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë.

Në një konferencë për media, përfaqësuesit e Parlamentit Studentor njoftuan se marshi do të nisë në orën 11:30 nga Qendra e Studentëve dhe do të vazhdojë drejt sheshit "Skënderbeu". Në orën 12:00, në shesh, studentët do të mbajnë edhe fjalime.

Flon Kastrati nga Parlamenti Studentor tha se marshi është organizuar si një thirrje për unitet, dinjitet dhe solidaritet. Ai bëri të ditur se studentët kanë përgatitur edhe një memorandum me gjashtë pika, i cili do të prezantohet gjatë aktivitetit.

"Parlamenti Studentor i Universitetit të Prishtinës e ndjen si obligim moral që ta ngrejë zërin për zhvillimet e fundit, pas vendimit të Gjykatës Speciale. Si studentë dhe si brez i ri, jemi të vetëdijshëm për luftën e drejtë të popullit tonë dhe rolin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në çlirimin e vendit", tha Kastrati.

Ai shtoi se thirrja për marsh u është drejtuar studentëve, të rinjve dhe qytetarëve, ndërsa theksoi se aktiviteti synon të përcjellë mesazhe për unitet, dinjitet dhe solidaritet.

Edhe



LAJMET E MBRËMJES • 9 orë më parë

Studentët marshojnë të hënë, partive politike u bëjnë thirrje për unitet

"Ky marsh është thirrje për unitet dhe e ka në qendër unitetin, si e vetmja zgjidhje deri në fjalën e fundit të drejtësisë. Marshi bën thirrje për unitet, dinjitet dhe solidaritet në një moment të rëndësishëm për vendin tonë", deklaroi ai.

Sipas Kastratit, në organizim do të marrin pjesë edhe studentë nga universitete të tjera publike dhe private. Memorandumi me gjashtë pika do të lexohet gjatë marshit dhe do të publikohet pas përfundimit të tij.

Showbiz.

Werner Herzog parashikon gjëra të mëdha për Orlando Bloom

Lifestyle.

Cilat simptoma sëmundjesh nuk duhet t'i injoroni?

Showbiz.

Gwyneth Paltrow tregon për vështirësitë pas ndarjes me Chris Martin

Futboll.

Parisi fiton derbin ndaj Marseillet

Futboll.

Fitore bindëse e Milanit

Botë.

Merz e quan "katastrofë" rezultatit e CDU-së, por premtan se do të qëndrojë në detyrë

Ndërkaq, Donart Humolli nga Parlamenti Studentor tha se studentët e konsiderojnë vendimin ndaj ish-krerëve të UÇK-së të padrejtë dhe kërkoi mbështetje për ta deri në përfundimin e procesit gjyqësor.

“Parlamenti Studentor i Universitetit të Prishtinës ndjen obligim moral dhe përgjegjësi qytetare që të ngrejë zërin sot ndaj vendimit që e konsiderojmë thellësisht të padrejtë ndaj çlirimtarëve tanë. Nuk kemi se si të jemi të qetë derisa ata që na sollën lirinë, falë të cilëve ne sot studiojmë dhe arsimohemi të lirë, gjenden në Hagë”, tha Humolli.

Ai kërkoi mbështetje financiare, politike dhe morale për të akuzuarit, si dhe bëri thirrje për unitet.

Edhe



Arbëri • 19 sht 2026

Organizatorët apelojnë te partitë të mos i politizojnë protestat kundër vendimit të Speciales

“Në këtë linjë, kërkojmë mbështetje financiare të pakushtëzuar, si dhe mbështetje të plotë politike e morale për të akuzuarit, deri në përfundimin e këtij procesi dhe derisa t’i kemi çlirimtarët tanë në shtëpitë e tyre, pranë familjeve të tyre”, u shpreh Humolli.

Ai u bëri thirrje edhe partive politike që të bashkëpunojnë dhe të vendosin unitetin mbi interesat e përditshme politike.

“Me këtë rast, shfrytëzojmë rastin t’u bëjmë thirrje të gjitha partive politike në vend që të tregojnë pjekuri, të gjejnë gjuhën e bashkëpunimit dhe të vendosin unitetin mbi interesat ditore, për hir të gjeneratave që po vijnë”, tha Humolli.

Në fund, ai kërkoi që procesi gjyqësor në Hagë të herohet dhe monitorohet nga organizatat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Edhe



Arbëri • 21 gus 2026

Katër ditë para vendimit të Speciales, marshohet nën moton “Kosova po pret”

“Njëkohësisht, kërkojmë hetim dhe monitorim të detajuar të procesit gjyqësor në Hagë nga organizatat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Besojmë fuqimisht se ky vendim dënues ka qenë i padrejtë dhe bie ndesh me parimet e drejtësisë”, deklaroi Humolli.

Sipas tij, procesi kërkon transparencë maksimale dhe monitorim ndërkombëtar për të garantuar, siç tha ai, që të mos prodhohet një “padrejtësi historike”.

#PARLAMENTI STUDENTOR

#GJYKATA SPECIALE

Artikuj të ngjashëm



LAJMET E MBRËMJES • 27 pr 2026

Studentët e vitit të parë kërkojnë t’u lejojnë provimet në afatet e prillit dhe të nëntorit



Arbëri • 13 shk 2026

Studentët në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së

apo i modifikuar ne çfaredo menyre, pa lejen paraprake te KOHA-s. Shfrytezimi i materialeve nga nevojte taqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisve që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhordh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.